



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 30 prill 2019, në mbledhjen e dytë (2) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës dhe z. Bekim Karaxhia – OSBE.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari është i zënë në një takim, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKSB-së. Materialet konsideroj se i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës. Para se të fillojmë me mbledhjen, z. Bekim Zogianit Komandantit të ri të Stacionit të Policisë në Podujevë i urojmë suksese në punë.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19 shkurt 2019

U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit Policor z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi, ky është takimi im i parë në KKSB, sa i përket situatës së sigurisë në Komunën e Podujevës, nga data e mbajtjes së takimit të fundit të Këshillit gjendja e sigurisë në përgjithësi është e qetë. Gjatë muajit mars dhe prill janë të raportuara 205 raste të ndryshme kriminale, prej tyre 32 raste janë zbuluar dhe janë proceduar në procedura të mëtejme. Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi një ngritje të lehtë, 6 raste më shumë. Prej kohës kur kam marrë detyrën, nga data 8 prill të këtij viti, kemi filluar me një analizë të përgjithshme të përgjegjësisë, të situatës, krimeve etj. çështje të cilat i preokupojnë edhe banorët e Komunës së Podujevës dhe Policinë. Si çështje ende më problematike kemi atë të trafikut, për shkak edhe të rrugëve, parkingjeve, aksidenteve. Gjatë vikendit në fshatin kërpimëh kemi pas një aksident, si pasojë një person ka pësuar me fatalitet dhe të tjerët me lëndime të rënda. E kemi si prioritet angazhimin e Njësive policore në akset rrugore më të rrezikshme, ku planifikojmë pika kontrolluese me radar dhe çështje tjera që ndërlidhen me sigurinë e trafikut.

Gjatë kësaj periudhe i kemi pasur 9 plane operative në fuqi, janë shqiptuar gjithsejtë 231 gjoba në trafik, numri i veturave të konfiskuara është 81, pastaj 15 raste të armëve të konfiskuara. Megjithatë mund të themi se situata është e qetë dhe nuk ka ndonjë indikacion për prishjen e rendit dhe qetësisë në të ardhmen.

Pasi që jemi në muajin e shenjtë të Ramazanit me Kryetarin e Këshillit të bashkësisë Islame kemi pasur një takim javën e kaluar dhe do të jemi në kontakt vazhdimisht në mënyrë që edhe ky muaj të kalojë në mënyrën më të mirë. Gjithashtu kemi edhe fundin e vitit shkollorë, ku maturantët kanë mbrëmjen e maturës dhe testin e maturës, me DKA-në dhe Drejtorët e shkollave do të angazhohemi që këto të kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, ju falënderoj për ftesën për pjesëmarrje në këtë takim. Nga perspektiva e KFOR-it gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Podujevës është e mirë, situatë e qetë dhe stabile sikurse e potencoi edhe Komandanti i Stacionit të Policisë. Falë bashkëpunimit që ka KFOR-i me institucionet përgjegjëse për sigurinë do t'ia dalim të zgjidhim çdo çështje që do të paraqitëte shqetësim për sigurinë në përgjithësi. Ne kemi bashkëpunim të mirë dhe jemi të gatshëm që ky bashkëpunim të vazhdojë me institucionet përgjegjëse.

z. Naim Bajraktari, theksoi, gjendjen e përgjithshme të sigurisë e vlerësojmë të qetë dhe stabile. Për këtë jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë akterët e sigurisë: KFOR-in, Policinë e Kosovës, autoritetet civile lokale si dhe komunitetet e ndryshme të vendit. Gjatë periudhës së kaluar kemi rishikuar pikat që mund t'i konsiderojmë si më të rëndësishme për vlerësimin e rreziqeve eventuale, siç janë: digat, objektet e rëndësishme së veçantë, Ujësjellësi rajonal, shkollat, spitalet, urat, lumenjtë, rrugët, hekurudhat, ndërtesat e larta, pompat e derivateve të naftës etj.. Në kuadër të këtij domeni, gjatë kësaj periudhe kohore, në bashkëveprim me autoritet komunale kemi testuar kapacitetet dhe aftësitë tona të përbashkëta profesionale në raste emergjente përmes ushtrimit fushor treditor i quajtur “ Skifteri 3”, ku kemi parë se kemi një bashkëpunim të shkëlqyer ndërinstitutional. Përveç operacioneve shumë profesionale që pati ky ushtrim, këtë e karakterizoi edhe më tepër ana psikologjike, që u krijua një besim edhe më i lartë i komunitetit vendor në institucionet e veta të sigurisë. Shpresoj se kështu do të jetë edhe në të ardhmen, duke ju siguruar që Forca e Sigurisë do të jetë përkrahëse e juaja në prosperitetin dhe promovimin e sigurisë në vend.

znj. Donjeta Sheqiri, në raportin e Policisë u cek se gjatë kësaj periudhe ka pas 205 raste të veprave të raportuara. Do të ishte mirë që në takimet tjera të Këshillit të

specifikohen nëpër kategoritë përkatëse, në mënyrë që ne si Këshill të shohim se ku duhet të fokusohemi dhe të përkushtohemi më shumë.

z. Bekim Zogiani, theksoi, Raporti i Policisë përmban raste të ndryshme të veprave kriminale, por herave të tjera mund t'i specifikojmë në fushat që i takojnë.

z. Gëzim Namani, Stacioni i Policisë në të kaluarën kishte mungesë të personelit. Si qëndron tani puna dhe a ka tendencë të rritjes së numrit të zyrtarëve policor.

z. Bekim Zogiani, situata sa i përket zyrtarëve policor pothuajse është e njëjtë, nuk është gjendje e mirë. Në zhargonin policor llogariten rreth 10 njësi patrulluese. Duke marrë parasysh edhe moshën ku 80% e stafit janë mbi moshën 45 vjeçare do të thotë që me të vërtetë është një sfidë. Shpresojmë se me përfundimin e gjeneratës së re në Vushtrri, të na vijë një numër i caktuar në bazë të strukturës që është aprovuar. Nuk jemi në dijeni për numrin e saktë, por mendoj se do të jenë diku 10-15 zyrtarë. Numri i përgjithshëm i stafit në Stacionin e policisë në Podujevë është 101.

z. Faik Muçiqi, theksoi, kohë më parë kemi parë kthimin e një numri të qytetarëve të Kosovës nga Siria. A keni informacione se a ka banorë të Komunës tonë. Kjo është ngjarje e mirëpritur e kthimit, por qëndron çështja e akomodimit të tyre dhe trajtimi i tyre institucional.

z. Bekim Zogiani, në bazë të raporteve që disponojmë dhe vendimet e gjykatës në zonën e Komunës së Podujevës i kemi tre persona të gjinisë femërore të cilat me vendim të gjykatës janë në arrest shtëpiak.

z. Osman Kurtolli, sa i përket qytetarëve të kthyer nga Siria ne këtë e mirëpresim, por dua të theksojë se është fat i mirë që nuk kanë të bëjnë asgjë me Bashkësinë Islame. Bashkësia Islame do të ketë parasysh sjelljet dhe reagimet e tyre dhe në këtë aspekt do të jetë në koordinim me institucionet relevante. Deri më tani nuk janë vërejtur kurrfarë shenjash apo tendenca negative. Besoj se nuk do të paraqitet ndonjë problem rreth kësaj çështjeje. Përndryshe nëse ka nevojë për trajtim nga ana jonë ne jemi në dispozicion.

z. Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj pike ne e përmbysim me konstatimin që gjendja e përgjithshme e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës është e qetë dhe stabile, pa tendencë që kjo gjendje të përkeqësohet, së paku nuk kemi informacione nga institucionet që merren me grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve. Kjo është për t'u vlerësuar, në radhë të parë puna që bën Stacioni i Policisë në Podujevë por edhe Stacioni rajonal i Policisë në Lluzhan, si dhe institucionet tjera KFOR-i, FSK-ja. Kemi pasur ushtrimin treditor të suksesshëm, ku ka pasur aktivitete tjera që lidhen ngushtë me çështjen e sigurisë, siç ishte trajnimi me nxënësit e shkollave të Podujevës në rast të reagimit ndaj fatkeqësive natyrore. Ne bashkë me institucionet tjera përgjegjëse nuk duhet të jemi të kënaqur me këtë por duhet të jemi vigjilent, sikurse e theksoi Komandanti, tani kemi muajin e Ramazanit, në pushimet verore fillon ardhja e bashkatdhetarëve, pastaj kemi sezonin e dasmave etj. Falënderojmë për raportet e paraqitura dhe për kontributin e dhënë.

3. Informatë për sigurinë në shkolla dhe masat për ngritjen e sigurisë

z. Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, për këtë temë do të na informojë drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Agim Blakçori. Sikurse e potencoi Komandanti, përfundimi i vitit shkollorë gjithëherë përcjellët me një dozë euforike. Tani kemi mbrëmjet e maturës, mbrëmjet e semimaturës nëse do të organizohen, ekskursionet. Dua të njoftojë nëse nuk e keni këtë informatë, prej vitit të kaluar në MASHT dhe në disa komuna është zhvilluar një debat që të shikohet mundësia e ndryshimit të udhëzimit administrativ që rregullon çështjen e ekskursioneve dhe komuna e parë që ka marrë një hap radikal në këtë drejtim e që është në kundërshtim me rregullativën ligjore është Komuna e Ferizajit. Kryetari i

kësaj Komune para 2-3 ditësh pikërisht duke i analizuar çështjet e sigurisë ka marrë një vendim për ndalimin e organizimit të ekskursioneve, e që unë e përgëzoj për një hap të guximshëm, sepse vërtetë ekskursionet në Shqipëri veç ka herë janë shndërruar në biznes e jo për qëllime parësore. Fjalën e ka Drejtori i DKA-së.

z. Agim Blakçori, theksoi, shikuar në përgjithësi dhe duke u bazuar në raportet e Policisë dhe raportet e shkollave si dhe raportet e DKA-së në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt. Këtë konstatim e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar si dhe raportet e mbledhjeve të mbajtura gjatë muajit mars dhe prill nga këshilli Drejtues i Shkollave. Në funksion të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt në institucionet shkollore, Drejtori i DKA-së ka mbajtur mbledhje me të gjithë drejtorët e shkollave, ku janë trajtuar temat: -Siguria në shkolla-masat për parandalimin e dhunës në shkolla ; -Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla, ku kemi dalë me disa rekomandime për zbatim të vitit shkollor 2018/2019. Drejtori ndër tjera foli për fuqizimin dhe funksionalizimin e plotë të organeve qeverisëse-udhëheqëse dhe profesionale të shkollave. Nënvizoi, në kërkesë të DKA-së janë mbajtur mbledhjet e Këshillit Drejtues të Shkollave në të gjitha shkollat me temën masat për avancimin e sigurisë. Drejtori foli për çështjen e shërbimit psikologjik dhe pedagogjik në shkolla dhe theksoi se gjatë këtij viti kemi në plan rritjen e numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkolla. Drejtori gjatë prezantimit të informatës në detaje pasqyroi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë dhe ndërlidhen me sigurinë në shkolla: për sigurimin e transportit të nxënësve, për ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore, rrethojat e oborreve të shkollave, ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve për këmbësor me ç'rast kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdoj t'u jap përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla, pastaj me theks foli për bashkëpunimin me Stacionin e Policisë në Podujevë, ku e vlerësoi një bashkëpunim të ngushtë duke bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet e ndryshme; nevojën për instalimin e kamerave të sigurisë në shkolla, ku veçse janë duke u zhvilluar procedurat tenderuese për këtë projekt. Shkollat përfituese të këtij projekti do të jenë Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani", SHMLT "Fan S. Noli", SHMLE "Isa Boletini", SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova", SHFMU "Shaban Shala", IP "Armela". Si sfida drejtori përmendi incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve, dëmtimet në objektet e disa shkollave nga persona të panjohur pas përfundimit të orarit mësimor, lokalet afër shkollave, qentë endacak, komunikacionin, trotuaret, mungesa e kamerave të sigurisë në shkolla, mungesa e rojës në shkolla.

Drejtori përfundoi informatën duke iu referuar bashkëpunimit të ngushtë që ka me të gjitha institucionet përgjegjëse në fushën e sigurisë publike.

z. Bekim Zogiani, theksoi, Policia e Kosovës është duke mbajtur ligjërata nëpër shkolla me temat për substancat narkotike dhe për pasojat që shkaktohen nga përdorimi i saj. Deri më tani ligjëratat i kanë ndjekur 1304 nxënës, më pastaj kemi planifikuar edhe tema tjera të ndryshme. Kemi kërkuar që së bashku me Drejtorinë e Arsimit ta mbajmë një takim me këshillin e Prindërve para përfundimit të këtij viti. Sa i përket Policisë disa prej tyre i kemi të angazhuar në rroba civile që kujdesen për çështjen e sigurisë nëpër shkolla. Sot kemi një rast të raportuar, dëmtimin e shkollës në fshatit Dumnicë, objekti vetëm është demoluar dhe jemi në hetim të atij rasti.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, ne e dimë mungesën e kapaciteteve fizike në Stacionin e Policisë në Podujevë. Si Komuna më e madhe me territor në nivel vendi që jemi, ndoshta edhe 10-15 policë të rinj do të ishin pak, megjithatë jemi të kënaqur që

edhe me këtë numër modest të policëve gjendja e sigurisë në Komunën tonë mbetet e qetë. Sa i përket rastit të fundit që e përmendi Komandanti, shërbimin që e bëjnë dy policë në rroba civile për sigurinë në shkollë, dua të shfrytëzoj rastin të përgëzojë policët të cilët gjithmonë janë pranë shkollave, duke ju ndihmuar nxënësve, drejtorëve të shkollave, që të ketë sa më pak probleme dhe evitim të tyre, kështu që puna e tyre duhet vlerësuar, edhe pse në konceptin më bashkëkohorë të shkollës kjo nuk do të ishte dashur të ishte kështu, të ketë polic pranë shkollave. Kërkesë e jona është që për shkak të rrethanave edhe më tutje të vazhdojnë aktivitetin policët në rroba civile.

z. Faik Muçiqi, për fat të mirë kemi një numër të madh të shkollave dhe sigurisht siguria e nxënësve është atakuar aty ku mungojnë trotuaret. Ne kemi ndërtuar trotuare të shumta afër shkollave dhe rrugëve që shpijnë në shkollë dhe jemi duke vazhduar në ndërtimin e tyre. Drejtori në detaje foli për lokacionet ku janë ndërtuar trotuaret. Nënvizoi, jemi në procedurë të prokurimit për ndërtimin e një mori të trotuareve kryesisht afër shkollave. Një buxhet bukur i madh shkon në ndërtimin e trotuareve. Sa i përket qenve endacak, ky problem vitin e kaluar është trajtuar nga Niveli Qendror, mirëpo si duket ky ishte një plan me kohë të caktuar dhe si duket pas përfundimit nuk ka vazhduar. Çështja e qenve endacak vazhdon të jetë problematike dhe shqetësuese. Lidhur me këtë u kemi drejtuar me shkresa disa herë autoriteteve qendrore, ku i kemi paraqitur shqetësimet tona, gjendjen aktuale dhe pasojat nga qentë endacak dhe si përgjigje na është kthyer se ende nuk kanë ndonjë buxhet shtesë për të vazhduar me trajtimin e tyre, ndërsa Komunat me buxhetin që kanë nuk mund të bëjnë trajtimin e tyre. Ne kohë më parë kemi ndërmarrë veprime në këtë aspekt, mirëpo kjo po kundërshtohet nga shoqatat për mbrojtjen e kafshëve. Drejtori foli edhe për ndriçimin, duke theksuar planet për zgjerim të ndriçimit, me theks pran shkollave dhe aksin rrugor kah fshati Peran, në segmentin ku po ka më së tepërmi aksidente të trafikut.

z. Bekim Zogiani, theksoi, është një kërkesë e Stacionit të Policisë për vendosjen e një pengese në rrugë pran shkollës në fshatin Dobërdol. Edhe pse në rrugë janë disa pengesa më të vogla të njëjta nuk po tregojnë efektin e duhur në zvogëlimin e shpejtësisë së automjeteve. Pastaj, në një segment të të njëjtës rrugë është duke u grumbulluar një masë e ujit për shkak të trotuarit shumë të lartë, kjo është pengesë dhe rrezikshmëri në komunikacion, pyetja është se a mund të ndërmerret diçka për largimin e ujit.

z. Qefser Sadiku, theksoi, kemi një problem, në pjesën e rrugës mbi shkollën e fshatit kërpimëh, automjetet po i lëshojnë në shpejtësinë (0) ku janë duke zhvilluar shpejtësi të jashtëzakonshme, duke mos menduar fare për rrezikun ndaj banorëve, në veçanti ndaj nxënësve. Edhe më herët e kam potencuar dhe kam bërë kërkesë për vendosjen e ndonjë barriere me qëllim të përshtatjes së shpejtësisë së automjeteve. Kërkesa tjetër është për sigurimin e ujit të pijes, mungesa ndihet në përgjithësi, veçanërisht në shkollë. Çështje tjetër që paraqet shqetësim për banorët dhe nxënësit janë qentë endacak. Mendoj se duhet të ndërmerret diçka lidhur me çështjet që theksova.

z. Nuhi Selimi, fillimisht përshëndes Komandantin e ri duke i uruar suksese në punë. Çështja e sigurisë ndërlidhet me shumë faktor. Ne si banorë të fshatit Orllan na shqetëson rruga, ka vozitje të shpejta, kemi bërë disa kërkesa për vende të pengesave në rrugë, në veçanti të shkollë dhe përtej objektit të postës. Edhe sa i përket trotuarit ka problem, kërkesa është dhe ka qenë për shtrirje të trotuarit te ura, sepse është shumë i nevojshëm, në veçanti për nxënësit, përndryshe qarkullimi nëpër urë është shumë i rrezikshëm. Pastaj si çështje problematike kemi edhe mungesën e rrethojës së oborrit të shkollës, aty hyjnë qen dhe bagëti, kështu që ka shumë nevojë ti bëhet rrethoja.

Kërkoj nga Komandanti i Policisë që mundësisht policët në fshatin Orllan të mos i angazhojë në detyra tjera në rajon, sidomos gjatë sezonit të verës, pasi që është shumë e nevojshme prezenca e tyre në Orllan.

Pastaj kur jemi te çështja e sigurisë është mirë që edhe inspeksioni komunal t'i inspektojë dhe t'i kontrollojë lokalet afariste pran shkollave sepse janë duke u shitur cigare nxënësve dhe gjëra tjera që nuk duhet shërbyer. Kjo të bëhet me qëllim të mbrojtjes së nxënësve nga dukuritë negative.

znj. Donjetë Sheqiri, është bërë dukuri dhe po krijohen mundësitë që nxënësit të konsumojnë duhanin, por gjithashtu edhe pije tjera alkoolike për shkak të lokaleve që ekzistojnë sidomos te shkollat e mesme, duke mos përjashtuar edhe substancat narkotike. U përmendën edhe incidentet dhe zënkat mes nxënësve, do pyesja Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit se a ka shqyrtuar mundësinë për t'i pajisur me uniforma nxënësit e shkollave të mesme, sepse mendoj se kjo do të luante një rol të madh në parandalimin e zënkave sepse jemi në dijeni se hyjnë dhe dalin kushdo dhe nuk vërehen se a janë nxënës.

Liman Zeqiri, sikurse jeni në dijeni është çështje shumë delikate dhe e ndjeshme dhe përgjegjësi morale dhe njerëzore e të gjithë neve për të mbrojtur ardhmërinë tonë, fëmijët. Edhe në takimet tjera kemi pasur diskutime për të ngritur numrin e zyrtarëve policorë, ajo është një çështje që nuk varet nga ne, por e kemi si detyrë, obligim moral të kërkojmë. Duke u bazuar në këtë çështje ju z. Nënkryetar, pasi që keni qenë edhe Drejtor i DKA-së dhe njohës i mirë i kësaj çështjeje, duke përfshirë edhe Drejtorin e DKA-së, mendoj se do të ishte mirë të angazhoheni që në të ardhmen ta kemi një kompleks të shkollave të mesme të larta, që të jetë një qendër, kështu do të funksiononte më mirë dhe do të menaxhohej më lehtë. Sa i përket policisë, i përgëzoj për punën e tyre, ndërsa ne kemi përgjegjësi të ndikojmë të gjithë në kuptimin pozitiv, të ndihmojmë procesin, sepse rrethanat dhe koha ka ndikuar në kuptimin e rasteve të dukurive negative.

z. Osman Kurtolli, theksoi, nxënësit në fshatin tonë janë duke iu ekspozuar rrezikut në rrugën e fshatit për shkak të shpejtësisë së madhe të automjeteve që janë duke zhvilluar. Është kërkesë e imja por edhe e banorëve të fshatit për vendosjen e disa pengesave në rrugë, pavarësisht asaj se përgjegjësi e kujt është kjo duke marrë parasysh kategorizimin e rrugëve. Fshati Shajkoc dhe fshati i Bajçinës janë fshatrat me qarkullimin më të madh të automjeteve në nivel të Komunës, kështu që vendosja e pengesave është shumë e nevojshme. Unë kam marrë një iniciativë për hapjen e rrugës në aksin te varrezat e fshatit dhe kërkesa është që në atë pjesë të bëhet një trajtim nga Komuna sepse ka të bëjë me sigurinë, ngase po bllokohet komunikacioni në mungesë të parkingut adekuat. Rasti tjetër është te shkolla, dua të përmend një fushë të sportit e cila është ndërtuar nga mërgata shqiptare nga fshati ynë, është e nevojshme ndërtimi i një trotuari përballë shkollës, duke marrë parasysh lëvizjen e nxënësve që është jashtëzakonisht e madhe. Qëllimi nuk është për investime të projekteve që kanë të bëjnë me sigurinë publike vetëm në fshatin Shajkoc por edhe në rajone tjera, sikurse e potencoi Drejtori i DKA-së. Me vetiniciativa kemi realizuar shumë çështje në interes të përgjithshëm. Unë, fjala vjen çdo herë i kam ikur donacioneve të huaja për ndërtimin e xhamive, me qëllim që t'i ndërtojmë vet me mjete vetanake. E përsëris vendosja e pengesave dhe shtrirja e rrjetit të ndriçimit në fshatin Shajkoc janë shumë të nevojshme.

z. Liman Zeqiri, theksoi, sikurse jeni në dijeni fshati Kaqybeg fare nuk ka objekt shkollorë dhe çështje problematike është që nxënësit nga ky fshat vijojnë mësimet në shkollat e fshatit Batllavë dhe atë të fshatit LLugë dhe ajo pjesë e rrugës është pa trotuare, një gjatësi shumë e madhe. kërkoj që në të ardhmen në kuadër të mundësive t'i bëhet zgjidhje këtyre banorëve dhe nxënësve, të ndërtohet trotuari.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, nëse nuk keni diçka rreth kësaj teme, e përmbysim dhe kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, për sigurinë e këmbësorëve në tërë territorin e Kosovës ende po ka nevojë që të ndërtojmë barriera në rrugë dhe kohën e fundit janë duke u ndërtuar më të gjëra, të cilat njëherit po shfrytëzohen edhe si vendkalim i këmbësorëve. Nënkyetari përmendi akset rrugore në të cilat është e nevojshme ngritja e barrierave. Falënderojmë Drejtorin dhe të tjerët që kontribuan në këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni diçka tjetër, e përmbysim dhe kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

4. Informatë për dinamikën e realizimit të projektit të vendosjes së kamerave të sigurisë

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, e kemi thënë edhe më parë se vendosja e këtyre kamerave do të ndikonte dukshëm në zvogëlimin e veprave kriminale dhe ofrimin e një sigurie, por do të ndikonte edhe në aspektin psikologjik të qytetarëve por edhe kryesve të mundshëm të veprave penale. Tani veç jemi në përfundim të procedurave për realizimin e këtij projekti. Fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Administratës i cili do të na informojë rreth ecurisë së implementimit të këtij projekti të rëndësishëm. Ne nuk do të ndalemi vetëm në këtë fazë, por vazhdimisht do të kërkojmë edhe si KKSB që ai rrjet i kamerave të zgjerohet, të përfshijë sa më shumë rrugë dhe lagje. Tash për tash jemi përcaktuar në pikat kyçe, aty ku bëhet qarkullimi dhe frekuentimi më i madh i qytetarëve.

z. Gëzim Namani, theksoi, sa i përket projektit në fjalë procedurat tenderuese veç se kanë përfunduar, është përzgjedhur operatori dhe projekti ka filluar sipas planit dinamik. Sot personalisht isha në vizitë së bashku me menaxherin e kontratës në terren. Drejtori informoi saktësisht edhe për pikat ku është filluar me instalimin e rrjetit dhe vendosjen e kamerave. Nënvizoi, për shkak të punimeve në rrugën “Zahir Pajaziti”, do të vazhdojmë me projektin në rrugët anësore të qytetit. Të gjitha hyrjet dhe daljet e qytetit do të mbulohen me kamera. Sistemi është i cilësisë së lartë, ndërsa monitorimi i takon Stacionit të Policisë, ku kërkohet edhe personel i veçantë, i trajnuar. Mendoj se në rrugën “Zahir Pajaziti” do të ketë ca vonesa për arsyet e cekuar, megjithatë do të jemi brenda planit dinamik.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, Nëse nuk keni diçka rreth kësaj teme kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

5. Të ndryshme

Nuk pat diskutime

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, unë ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën.14:40

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/01-0036051/19
Podujevë, 30 prill 2019**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**